

**VENDIM**  
**Nr. 42, datë 22.12.2021**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                     |           |
|---------------------|-----------|
| Vitore Tusha        | kryetare; |
| Elsa Toska          | anëtare;  |
| Marsida Xhaferllari | anëtare;  |
| Fiona Papajorgji    | anëtare;  |
| Altin Binaj         | anëtar;   |
| Sonila Bejtja       | anëtare,  |

me sekretare Enina Kotoni, në datën 22.12.2021, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 11 (K) 2021 të Regjistrat Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, zonja Vitore Tusha.

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Përparim Kalo.

BAZA LIGJORE: Nenet 127, pikat 1, shkronja “b”, 2 dhe 3, si dhe 129 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 8, pika 3, dhe 9, pikat 1, shkronja “b”, dhe 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatimin e bërë nga Kryetarja dhe administroi dokumentacionin e çështjes,

**VËREN:**

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me dekretin nr. 8066, datë 22.3.2013, ka emëruar zotin Besnik Imeraj anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 7/2013, datë 1.4.2013, ka dhënë pëlqimin për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

2. Në datën 8.4.2013, zoti Besnik Imeraj ka bërë betimin para Presidentit të Republikës dhe ka filluar ushtrimin e mandatit kushtetues.

3. Me vendimin nr. 2, datë 31.1.2018, Gjykata Kushtetuese ka vendosur deklarin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Besnik Imeraj, në datën 31.1.2018, për shkak të heqjes dorë nga detyra.

4. Pas krijimit të kësaj vakance, Presidenti i Republikës, si organ i emërtesës, në përputhje me parashikimet e reja kushtetuese dhe ligjore në fuqi, me dekretet nr. 10723, datë 7.2.2018, nr. 11291, datë 27.9.2019 dhe nr. 11742, datë 24.9.2020, ka shpallur dhe rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme.

5. Presidenti i Republikës, në përfundim të procedurave të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, të zhvilluara nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi është njohur me praktikën dokumentare të vendimmarrjes dhe vlerësimit të këtij organi, listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve të lejuar për kandidim dhe raportin e arsyetuar të renditjes së tyre për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese (vakancë e parakohshme), me dekretin nr. 11882, datë 23.12.2020, ka emëruar zotin Përparim Kalo anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Ky i fundit, në datën 24.12.2020, ka bërë betimin para Presidentit të Republikës.

6. Në datën 7.12.2021, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese ka paraqitur kërkesë për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Përparim Kalo, për shkak të përfundimit të mandatit 9-vjeçar të plotësuar prej tij.

7. Në datën 15.12.2021, gjyqtari Përparim Kalo i ka paraqitur kërkesë Gjykatës Kushtetuese për interpretimin e dispozitave të ligjit nr. 8577/2000, që kanë të bëjnë me mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues, duke pretenduar, në thelb, se mandati plotësues duhet të llogaritet bazuar në ushtrimin efektiv të tij.

8. Gjykata vëren se neni 125, pika 3, i Kushtetutës, parashikon se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë rrimërimi, kurse sipas nenit 127, pika 3, të saj, në rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, organi i emërtesës emëron një gjyqtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar. Gjykata vëren, gjithashtu, se sipas nenit 129 të Kushtetutës, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës, kurse sipas nenit 8, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese fillon nga data e betimit dhe mbaron në datën e njëjtë të atij muaji të vitit të nëntë, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

9. Neni 127, pika 2, i Kushtetutës parashikon: *“Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese.”*. Kjo dispozitë është zbrëthyer në nenin 9, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilave: *“Kërkesa për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit bëhet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të mandatit të një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese, sipas pikës 1, shkronjat “a” dhe “b”, të këtij neni, si dhe menjëherë në rastet e mbarimit të mandatit përpara afatit ligjor, njofton organin e emërtesës për vendin vakant. Procedura për emërimin e gjyqtarit të ri përfundon jo më vonë se 60 ditë nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka deklaruar përfundimin e mandatit.”*.

10. Për sa më sipër, në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ato të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata vlerëson se mandati i anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Përparim Kalo, mbaron në datën 8.4.2022, për rrjedhojë kërkesa është e bazuar dhe duhet pranuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 127, pikat 1, shkronja “b”, 2 dhe 3, si dhe neneve 8, pika 3, dhe 9, pikat 1, shkronja “b”, dhe 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Përparim Kalo, në datën 8.4.2022.

- Njoftimin e këtij vendimi Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë.

Marrë më 22.12.2021.

Shpallur më 7.1.2022.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtare: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji

Anëtar kundër: Altin Binaj